



**Komuna e Klinës**

**Zyra e kryetarit të Komunës**

01Nr. 06-3829 2025

Klinë, dt. 05.02.2025

### PROCESVERBAL

**Nga takimi i dytë i kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj me qytetarë, mbajtur me datë 26. 12. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

Takimin e dytë me qytetarë, kryetari i komunës z. Zenun Elezaj e hapi duke përshëndetur të gjithë të pranishmit në sallën e kuvendit të Komunës. Z. Elezaj, përshëndeti edhe kryetarët e këshillave lokale që ishin prezent në këtë takim, kryetarë këta të zgjedhur në një proces të rregullt siç e tha z. Elezaj.

Në vazhdim kryetari tha se do të prezantoj në pika të shkurtra rrjedhjen e parasë publike, projektet e realizuara, sfidat etj.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Këtë vit duke filluar që nga fillimi, me datë 3 janar kemi filluar me përgatitjet e nevojshme për të filluar procedurat e prokurimit me qëllim të implementimit të buxhetit të aprovuar paraprakisht. Edhe ky vit ka qenë një vit i suksesshëm. Janë lidhur 52 kontrata që janë përfunduar deri me tani, 26 kontrata kornizë dhe 37 kontrata në realizim. Pra është një vit i suksesshëm në aspektin e menaxhimit të prokurimit. Nga kategoritë paga dhe mëditje kanë qenë të aprovuara 7 milion e 936 mijë e 857 euro ndërsa janë shpenzuar 8 milion e 5 mijë e 45 euro, kemi pasur pak minus e që është 101%. Shpenzimet kapitale; buxheti i aprovuar ka qenë 4 milion e 987 mijë e 996.7 euro dhe janë shpenzuar 4 milion e 583 mijë e 11 euro, apo në %, 91.88%. Kategoria Mallra dhe Shpenzime, 96.21% buxhet i realizuar. Kategoria subvencione dhe transfere 96.38% i shpenzuar. Kategoria shpenzimet komunale është shpenzuar 100%. Në total buxhet i aprovuar 15 milion e 690 mijë e 59.99 euro dhe i shpenzuar 15 milion e 329 mijë e 888 euro, 97.7%. Mendoj që i gjithë angazhimi ynë nënkupton shfrytëzimin sa më racional që kryesisht në performancë vlerësohet % e shpenzimit të buxhetit në shpenzimet kapitale dhe shihet që është shpenzuar racionalisht dhe shumë mirë dhe korrekt. Prej projekteve në përgjithësi janë projekte të parapara me buxhetin e aprovuar por në veçanti do të përmendja një projekt që ju intereson të gjithë qytetarëve. Është projekti për furnizim me ujë të pijshëm, i cili projekt, kontrata është nënshkruar para një vitit dhe me plan dinamik ka pas për të përfunduar me 15 dhjetor. Me 15 vjetor kompania i ka përfunduar punimet dhe është në fazën e testimi ku nga kjo datë kompania "Hidrodrini" e merr në menaxhim projektin. Shpresojmë diku që në javët e para të Janarit do të filloj implementimi i projektit dhe të kemi ujë të pijshëm. Projekte të tjera prej më të mëdha janë trajtimi i ujërave të zeza ku këtë vit kemi impiantin biologjik për trajtimin e ujërave të zeza në Gllarevë. Çdo vit po ndërtojmë nga një impiant. Gjithashtu më në fund këtë vit kemi filluar edhe projektin e transitit me gjatësi prej 10 km, me suksese kemi kontraktuar operatorët por që ky projekt është i kushtëzuar nga



shpronësimit të pronave. Memorandumi i mirëkuptimit thotë se Ministria e infrastrukturës bart procedurën e shpronësimit. Kemi premtime që do të rritet kontributi i qeverisë pasi që ky projekt është tre vjeçare por gjithsesi edhe komuna është në bashkëfinancim. Ky projekt do ta lehtësojë qarkullimin e automjeteve që kalojnë nëpër komunën e Klinës. Sipas premtimit të kompanive, sektori prej Gremniku deri në rrugën për Skenderaj do të lëshohet në shfrytëzim brenda vitit.

Unë prezantova këto të dhëna por me kryetarët e këshillave të fshatrave do të bëjë takime të veçanta dhe të rregullta. Kanalizime, rrugica nëpër fshatra dhe ndriçimi publik do të përfundojë me buxhetin e vitit të ardhshëm por gjithsesi unë do të jem në teren dhe në bashkëpunim të ngushtë me gjithsecilin. Tani që i kemi kryetarët e këshillave të fshatrave të cilët bashkë me kryesitë e tyre është mirë që të identifikojnë alternativa për furnizim me ujë të pijshëm në ato fshatra që nuk e kanë të rregulluar këtë çështje dhe më pastaj bashkë do t'i analizojmë dhe të bëjmë zgjidhjen e duhur. Ne jemi të gatshëm që nga fillimi i vitit të ardhshëm të organizojmë takime të ndara me këshillat e fshatrave në mënyrë që ti zgjidhim të gjitha problemet dhe nevojat.

Jam i gatshëm që të ju dëgjoj gjithsecilin nga ju. Fjala është për ju.

**z. Kushtrim Haliti, përfaqësues i fshatit Jashanicë:** Përshëndetje për të gjithë. Fshati im nuk u përmend për asnjë investim. Dua të dijë se a është planifikuar që në vitin e ardhshëm të instalohet ndriçimi publik në Jashanicë. Po ashtu për ujë të pijshëm sepse një pjesë e fshatit nuk ka qasje në ujësjellës.


**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Ndriçimi do të përfundojë në të gjitha fshatrat e Komunës në linja të mëdha. Do të ulemi bashkarisht që të diskutojmë më kryesitë e fshatit për ndriçim ndërsa për ujë të pijshëm e di që një pjesë e Jashanicës është me Skenderaj por do të i bëjmë shpresë Hidrodrinit dhe ne jemi të gatshëm që të bashkëfinancojmë me ta, që të zgjidhet ky problem.

**z. Binak Gashi, përfaqësues i fshatit Gremnik:** Përshëndetje të gjithëve. Besoj që është përfunduar një punë shumë e mirë me zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe besoj që komunikimi me kryetarin do të jetë më i shpeshtë dhe më i mirë. Ju uroj të gjithëve festat e fund vitit.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Pasi që ti e përfaqëson edhe fshatin Dresnik, dua të shtoj që Dresniku është një prej pjesëve që ka nevojë të bëhet investime në infrastrukturë. Për këtë vit ne kemi planifikuar një investim të madh prej 600 mijë euro por është mirë ju si kryetar të i identifikoni dhe mbani shënim nevojat në atë fshat dhe të i diskutojmë bashkë kur të takohemi. Rrugët kryesore në Dresnik do të lidhen me rrugën transit. Rrugët lokale janë problem sepse duhet shpronësi. Juve si kryesi ju mbetet punë më e madhe që të diskutoni në fshat që të gjitha banorët që duan të ju shtrohen rrugët lokale të japin pëlqimin nga pronari i tokës.

Pasi që nuk kishte asnjë tjetër të interesuar për të diskutuar, kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe duke i uruar të gjithëve festat e fund vitit, e shpalli të mbyllur këtë takim.

Procesmbajtës:  
Skënder Behramaj



Kryetari:  
Zenun Elezaj

